

## PROCESVERBAL

### I GJENDJES TEKNIKE, ESTETIKE DHE FUNKSIONALE TE MJETIT

I mbajtur sot, më datë 28.4.2010, nga Komisioni i Ankandit i ngritur me urdhër nr. 16, datë 10.2.2010, “Për nxjerrjen në ankand të automjeteve të DSIK-së”, të Drejtorit të DSIK-së, për vlerësimin e mjetit të transportit autoveturë tip WOLKSVAGEN GOLF, me targë EPK 4577. Në bazë të VKM, nr. 1242, datë 16.12.2009, pika II, nënpika 1 “Hartimi i dokumentave të ankandit dhe format e komunikimit” dhe pika III, nënpika 2 “Informacion për objektin e shitjes”, Komisioni pasi inspektoi mjetin e transportit të lartpërmendur dhe shqyrtoi dokumentacionin përkatës:

Konstaton:

#### Karakteristikat teknike të mjetit:

Tipi i mjetit: VETURË

Marka : WOLKSVAGEN

Modeli/Lloji : GOLF

Viti prodhimit: 1993

Pesha pa ngarkese: 990 Kg

Pesha me ngarkese: 1470 Kg

Karburanti: NAFTË

Numri i vendeve: 4+1

Nr. Identifikimit /Shasia: WVVZZZ1HZPB021397

Ngjyra : ZEZË

Targa: EPK 4577

Pronësia : DSIK

### **Gjendja funksionale dhe estetike:**

Nga të dhënat e nxjerra nga dokumentacioni i këtij automjeti, rezulton se:

1. Nga ana estetike automjeti është në gjëndje të mirë.
2. Mjeti ka përshkruar 299.813 km.
3. Motori nga gjëndja tenike është në gjëndje të mirë pune dhe ka nevojë për shërbime.
4. Sistemi i frenimit është në gjëndje pune.
5. Gomat janë të konsumuara dhe batistrata e deformuar.
6. Sistemi elektrik është në gjëndje pune.
7. Nga ana teknike automjeti është në gjëndje pune.

### **Vendodhja e automjetit:**

Në ambientet e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

### **Mendimi i Komisionit të Ankandit**

Mbështetur në VKM, nr. 1242, datë 16.12.2010, pika II, "Metoda e përdorur për nxjerrjen e vlerës fillestare" dhe shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nr. 1401/1Prot, datë 25.03.2010, "Në lidhje me vlerësimin e automjeteve të transportit që do të nënshtrohen procedurave të ankandit", Komisioni vendosi:

Autoveture tip Volkswagen Golf, me targë EPK 4577, ka vlerën fillestare të ankandit 75.000 lekë.

**Leja e Qarkullimit:** nuk ka. Dokumenti që vërteton pronësinë.

**Foto të mjetit:**



